

Kodi i organizatave civile





Ky projekt
financohet nga
Bashkimi Evropian



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK



CIVOS
Centre for Information Service,
Co-operation and Development of NGOs

Ky Kod i Organizatave të Shoqërisë Civile është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij Kodi është përgjegjësi e vetme e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

KODI I ORGANIZATAVE CIVILE

HYRJE

Liria e bashkimit është e drejtë themelore e njeriut e garantuar në nenin 20 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili thotë se “qytetarëve u garantohet liria e bashkimit me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe bindjeve të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe bindjeve dhe të drejtave tjera. “Kjo e drejtë na lejon neve si qytetarë të organizohemi lirshëm dhe të krijojmë dhe të marrim pjesë në grupe dhe shoqata civile, t’u qasemi atyre dhe të dalim prej tyre.

Jemi plotësisht të bindur se zhvillimi i demokracisë varet kryesisht nga respektimi dhe praktika e kësaj të drejte. Përmes bashkimit, neve na mundësohet të monitorojmë gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të mbështesim dhe promovojmë politikat e zhvillimit në shoqëri. Prandaj, shteti ka për obligim të sigurojë formim dhe pjesëmarrje të lirë në shoqatat e çdo lloji dhe të garantojë pavarësi në funksionimin e tyre. Si shoqatë jemi të lirë të kërkojmë dhe të pranojmë resurse financiare nga burime të ndryshme me qëllim për të realizuar programet dhe aktivitetet e tyre në interes të qytetarëve. Përveç Kushtetutës, në Maqedoninë e Veriut, garanci kryesore për punën tonë jep Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet, i cili përcajton qartë parimet themelore të punës së shoqatave.

Në Maqedoni, procesi i demokratizimit dhe liberalizimit ekonomik ka kontribuar në rritjen e numrit të organizatave civile në fusha të ndryshme sektoriale dhe ndikim në shoqëri. Në punën tonë, përveç veprimit të pavarur, ne shpesh shoqërohemi në platforma dhe rrjete të ndryshme të organizatave civile, në mënyrë që të kemi një ndikim më të madh në drejtim të përmirësimit të aspekteve të ndryshme të jetëve të qytetarëve.

Sot, gjithnjë e më shpesh ne kemi mundësi për bashkëpunim me sektorin publik dhe privat. Nga ne pritet që të tregojmë se ofrojmë shërbime cilësore, por edhe se menaxhojmë në mënyrë efektive organizatat tona madje edhe në rrethana të vështira dhe sfiduese. Pa dyshim, legjitimiteti ynë buron pikërisht nga cilësia e punës sonë dhe mbështetja e dhënë nga njerëzit me dhe për të cilët punojmë, nga anëtarët, donatorët, publiku i gjerë, institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare. Prandaj, për ne është imperativ të tregojmë se ne mundemi dhe dimë të vendosim një sistem të vetërregullimit përmes të cilit do të ofrojmë punë të bazuar në qeverisje të mirë, llogaridhënie, transparencë dhe efikasitet.

Ky Kod i Organizatave Civile synon të forcojë sistemin e vetërregullimit dhe të kontribuojë në profesionalizëm dhe llogaridhënie më të madhe. Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballemi sot është ndërtimi i besimit tek qytetarët dhe publiku i gjerë. Si organizata civile që veprojnë në nivel lokal dhe kombëtar, ne duhet të sigurojmë llogaridhënie më të gjerë për punën tonë dhe kështu të vërtetojmë interesin tonë publik në proceset e krijimit të politikave që janë me interes për qytetarët, e për të cilat marrim resurse.

Ky kod është vullnetar, ndërsa çdo organizatë civile e cila do t’i qaset ndërmerr përgjegjësi për respektimin dhe praktikimin e angazhimeve, vlerave dhe standardeve të përcaktuara në të. Kodi është materie e gjallë dhe do të promovohet dhe avancohet nga ana e organizatave civile në mënyrë konsekuente dhe të vazhdueshme.

Vlera jonë themelore është respektimi i të drejtave të njeriut si të drejta universale dhe të patjetërsueshme të të gjithë qytetarëve. Në punën tonë udhëhiqemi nga qasja e bazuar në të drejtat e njeriut dhe promovojmë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e tyre. Lufta kundër diskriminimit në të gjitha bazat është në thelbin e veprimeve tona shoqërore.

Duke u angazhuar për drejtësinë dhe barazinë ne i mbështesim njerëzit të njohin dhe përmbushin të drejtat e tyre dhe të kërkojnë përgjegjësi kur ata nuk respektohen. Qëllimi ynë është të ndërtojmë një shoqëri në të cilën të gjithë gëzojnë të drejtat dhe liritë e njëjta dhe dhe vendos lirshëm për jetët e tyre pavarësisht origjinës, përkatësisë kombëtare ose etnike, fesë apo besimit, statusit socioekonomik, moshës, gjinisë, seksit, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, besimi politik ose besimit tjetër ose cilido status tjetër shoqëror. Në bashkëpunim me të gjithë aktorët, ne përpiqemi të vendosim barazinë gjinore dhe të heqim pengesat për zhvillimin e grave, vajzave dhe të rinjve në shoqërinë tonë.

Përgjegjshmëria dhe transparencja janë vlerat tona të larta demokratike. Në komunikim me të gjithë aktorët, ne jemi të hapur, të sinqertë dhe veprojmë me integritet profesional, dhe fokusi i punës sonë është interesi publik.

Si organizata të shoqërisë civile, bëjmë përpjekje të veçantë për të vendosur pjesëmarrje dhe përfshirje në të gjitha aspektet e punës sonë. Promovojmë dhe praktikojmë pjesëmarrjen aktive të të gjithë qytetarëve të interesuar (veçanërisht të marginalizuarit dhe të privuarit nga e drejta, si dhe të rinjtë dhe të varfrit) në zhvillimin e komunitetit lokal. Angazhohemi për një proces vendimmarrës që bazohet në fidbek dhe që pasqyron të drejtat e njerëzve, interesat e të cilëve përfaqësojmë dhe/ose ata që janë të prekur nga puna jonë.

I respektojmë ligjet. Asnjë pjesë e fitimit që e realizojmë nuk u shpërndahet anëtarëve, punonjësve apo drejtorëve tanë, por riinvestohet në realizimin e misionit, qëllimeve dhe aktiviteteve tona të përcaktuara me Statutin, duke garantuar jofitimprurjen tonë.

Ne kujdesemi për mbrojtjen e mjedisit dhe qëndrueshmërinë e planetit tonë. Aktivitetet tona i realizojmë në mënyrë të qëndrueshme ekologjike. Si pjesë e shoqërisë civile i motivojmë qytetarët që të përfaqësojnë dhe promovojnë ndryshime sistemore për një planet të shëndetshëm ku brezat e ardhshëm do të mund të lulëzojnë dhe zhvillohen.

Ne veprojmë gjithmonë me besim në solidaritet, si një marrëdhënie lartë qytetare midis grupeve të ndryshme të qytetarëve dhe klasave që bashkohen për të përmbushur interes të përbashkët dhe një ndjenjë uniteti në nxitjen e ndryshimeve shoqërore.

1. VENDIMMARRJA E PËRGJEGJSHME DHE ORGANIZATA TRANSPARENTE

- 1.1 Organizatat civile janë katalizatorë për ndryshime pozitive shoqërore me një vizion, mision, grupe të synuara dhe shfrytëzues të përcaktuar qartë dhe të arritshme publikisht.
- 1.2 Puna e organizatave civile bazohet në një proces planifikimi njëvjeçar ose shumëvjeçar. Planet dhe projektet strategjike dalin dhe udhëhiqen nga nevoja për të përmbushur misionin organizativ dhe për të përmbushur nevojat e qytetarëve për të cilët ne veprojmë.
- 1.3 Punonjësit, anëtarët, shfrytëzuesit/konstituentët dhe mbështetësit janë përfshirë në mënyrë aktive në procesin e planifikimit strategjik dhe kështu kanë ndikim në proceset vendimmarrëse brenda organizatave.
- 1.4 Organizatat civile praktikojnë monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të rezultateve dhe qëllimeve të programeve dhe projekteve të tyre. Rezultatet e programeve dhe projekteve të realizuara kanë për qëllim krijimin e ndryshimeve të përhershme pozitive në shoqërinë maqedonase.
- 1.5 Organizatat civile praktikojnë të paktën raportim njëvjeçar mbi rezultatet e arritura dhe aktivitetet e realizuara në formën e një raporti organizativ vjetor. Këto raporte ndahen publikisht dhe janë lehtësisht të arritshme për të gjithë palët e prekura.
- 1.6 Organizatat civile posedojnë dhe zhvillojnë vazhdimisht shkathtësitë dhe kapacitetet e nevojshme për realizimin e programeve dhe projekteve.
- 1.7 Organizatat civile vazhdimisht synojnë të sigurojnë cilësi në punën e tyre në përputhje me trendet moderne zhvillimore të qasjes në punën në sektorin jofitimprurës.



2. QEVERISJA E MIRË

- 2.1 Organizatat civile që janë nënshkruese të këtij Kodi kanë miratuar Statut ose lloj tjetër akti të menaxhimit i cili përcakton qartë vizionin, misionin dhe qëllimet e organizatës.
- 2.2 Organizatat civile kanë një strukturë të qartë organizative me role, të drejta dhe përgjegjësi të ndara qartë midis organeve joekzekutive dhe ekzekutive. Puna e organizatave civile mbikëqyret nga organi i pavarur joekzekutiv i cili mban mbledhje rregullisht dhe shqyrton dhe miraton raportet vjetore të organizatave (narrative dhe financiare), shqyrton dhe vendos mbi politikat e rëndësishme organizative dhe vendimet, planet dhe programet kryesore financiare të punës.
- 2.3 Organi joekzekutiv që kontrollon punën e organizatës është organ i pavarur me rregulla të rregulluara qartë për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e anëtarëve të tij.



- 2.4** Anëtarët e organeve joekzekutive nuk marrin honorare për kryerjen e punës së tyre, përveç shpenzimeve të nevojshme për realizimin e mbledhjeve aktuale, gjegjësisht takimeve.
- 2.5** Udhëheqja në organizatat civile është vizionare, novatore dhe inkurajon krijimin e frymës ekipore në organet e organizatës.
- 2.6** Organizatat civile në punën e tyre sigurojnë pavarësi nga qeveria, partitë politike dhe aktorët e tjerë të fuqishëm shoqëror. Anëtarët e organeve e vënë interesin e organizatës mbi interesin personal, të udhëhequr nga detyra dhe përgjegjësia për të vepruar në interesin më të mirë të mundshëm ndaj shfrytëzuesve, konstituentëve dhe publikut të gjerë.
- 2.7** Organizatat civile e rregullojnë dhe deklarojnë qartë konfliktin e mundshëm dhe real të interesit në punën e tyre.
- 2.8** Informacionet mbi punonjësit, anëtarët, donatorët dhe mjetet financiare ndahet publikisht nga organizatat civile dhe janë të arritshëm lehtë për të gjithë palët e interesuar, e veçanërisht për publikun e gjerë.
- 2.9** Organizatat civile vendosin përfaqësim të barabartë gjinor në organet joekzekutive dhe ekzekutive të organizatave të tyre. Anëtarët e këtyre organeve janë anëtarë të grupeve të ndryshme shoqërore dhe pasqyrojnë sfondin e ndryshëm kulturor, multietnik dhe shoqëror të mjedisit në të cilin ata veprojnë.
- 2.10** Vendimet në organizatat civile miratohen me përgjegjësi dhe bazohen në një proces të vazhdueshëm të shkëmbimit të informatave dhe fidbekut me shfrytëzuesit dhe grupet e synuara.
- 2.11** Organizatat civile i shfrytëzojnë teknologjitë digjitale në interes të integritetit më të madh të grupeve të synuara dhe për të arritur misionin duke mbajtur llogari për respektimin e privatësisë. Informacionet personale me të cilat disponojnë organizatat janë të mbrojtur nga keqpërdorimet dhe ndarjet e paautorizuara me palët e treta.

3. FINANCIMI ETIK DHE UDHËHEQJA E PËRGJEGJSHME ME RESURSET

- 3.1** Mbledhja e mjeteve dhe donacioneve është për të realizuar misionin dhe qëllimet e organizatave të shoqërisë civile. Organizatat sigurojnë menaxhim të arsyeshëm dhe të përgjegjshëm të mjeteve financiare dhe resurseve dhe i përdorin ato me nikoqirllëk për dedikimin për të cilin kanë qenë të paraparë me qëllim të maksimizimit të arritjes së misionit.
- 3.2** Organizatat civile monitorojnë vazhdimisht shpenzimet dhe sigurojnë kontroll të brendshëm dhe sipas nevojës kontroll të pavarur të jashtëm financiar të punës së tyre.
- 3.3** Organizatat civile i respektojnë dhe zbatojnë sistemet financiare, kontabël dhe administrative të përcaktuara me ligj në mënyrë që të zvogëlojnë rrezikun nga keqpërdorimi i mjeteve dhe korrupsionit.



- 3.4** Organizatat civile sigurojnë raportim transparent mbi mjetet e siguruar dhe të realizuara në raportet e tyre vjetore organizative. Fondet e realizuara paraqiten në mënyrë që mundëson një kuptim të qartë të kategorive të ndryshme të shpenzimeve dhe mjeteve të marra nga burime dhe donatorë të ndryshëm.

4. LIDHJE TË FORTA ME PUNONJËSIT, ANËTARËSINË, MBËSH-TETËSIT DHE VULLNETARËT

- 4.1** Si punëdhënës, organizatat civile sigurojnë politika të drejta dhe transparente për punësimin e stafit të kualifikuar me njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme. Politikat e punësimit bazohen në mosdiskriminimin dhe respektimin e të drejtave të kategorive të marginalizuara dhe të cenueshme të qytetarëve.
- 4.2** Organizatat civile në punën e tyre praktikojnë një kulturë të llogaridhënies, ku punonjësit dhe vullnetarët kanë ndjenjë të fortë përgjegjësie për veprimet dhe ndikimin e tyre.
- 4.3** Organizatat civile janë të hapura për propozime nga anëtarët, mbështetësit dhe shfrytëzuesit e fundit dhe i zbatojnë ato për të përmirësuar punën dhe përfshirjen e tyre në realizimin dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve.
- 4.4** Organizatat civile investojnë resurse në ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve dhe matin vazhdimisht rezultatet e punës së tyre.
- 4.5** Organizatat civile sigurojnë të ardhura për punonjësit që llogariten sipas kompleksitetit të proceseve të punës dhe të ardhurave në sektorin publik dhe privat.
- 4.6** Organizatat civile ushqejnë dhe zhvillojnë vazhdimisht frymën vullnetare, ndërsa vullnetarët janë resurs për organizatat. Vullnetarizmi në organizatat civile është gjithmonë i mirëpritur dhe i vlerësuar. Varësisht nga nevojat dhe kushtet, vullnetarët kalojnë një trajnim të domosdoshëm specifik për kryerjen e detyrave të detyrave dhe monitorohen dhe mentorohen në punë.
- 4.7** Organizatat civile respektojnë kornizat ligjore të së drejtës në punë dhe sigurojnë rrogë të barabartë për punë të barabartë dhe kushte të mira pune.



5. PËRFAQËSIMI I PËRGJEGJSHËM

- 5.1** Organizatat civile përfaqësojnë në mënyrë aktive dhe publike për çështje të rëndësishme shoqërore, ndërsa përfaqësimi bazohet në dëshmi (të marra nga hulumtimet që janë të verifikueshme dhe/ose në komunikim të vazhdueshëm me grupet e synuara) dhe nevojat e njerëzve në komunitete.
- 5.2** Organizatat civile përfaqësojnë me integritet duke mbajtur llogari për vërtetësinë dhe sinqeritetin e procedurave. Në metodat e tyre të përfaqësimit nuk i ekspozojnë shfrytëzuesit dhe grupet e tyre të qytetarëve në rrezik, ndërsa përfaqësimi është në përputhje me misionin dhe qëllimet dhe në drejtim të avancimit të interesit publik.
- 5.3** Organizatat civile deklarojnë qartë në interesin e kujt përfaqësojnë në kuadër të aktiviteteve të tyre dhe në komunikim me të palët e prekur.



6. SHËRBIME TË ARRITSHME DHE TË PRANUESHME (SOCIALE) PËR KUJDESIN E SHFRYTËZUESVE.

- 6.1 Organizatat civile në ofrimin e shërbimeve (sociale) në fokus i kanë shfrytëzuesit e tyre të fundit dhe nevojat e tyre reale me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Shoqatat promovojnë shërbime që janë të barabarta dhe lehtësisht të arritshme për të gjithë shfrytëzuesit.
- 6.2 Kujdesi ndaj shfrytëzuesve bazohet në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke u udhëhequr nga parimet e lirisë së fjalës dhe shprehjes, lirisë së bashkimit, mosdiskriminimit dhe forcimit të kapaciteteve të shfrytëzuesve.
- 6.3 Në ofrimin e shërbimeve, shoqatat dhe fondacionet ofrojnë një linjë reagimi për të përmirësuar shërbimet. Programet e shërbimeve (sociale) u nënshtrohen vlerësimeve të rregullta të cilësisë së shërbimeve dhe avancohen vazhdimisht në përputhje me vërejtjet e marra dhe risitë në kontekstin social dhe ekonomik të komuniteteve.
- 6.4 Përmes programeve për dhënie të shërbimeve sociale i mbështesim shfrytëzuesit për të marrë rol aktiv në përmirësimin e jetëve të tyre si faktorë aktivë në transformimin e tyre.



7. PARTNERITETE TË FORTA

- 7.1 Organizatat civile në punën e tyre ndërtojnë partneritete të bazuara në respekt dhe mbështetje që kontribuojnë në zhvillimin reciprok.
- 7.2 Organizatat civile bashkëpunojnë me faktorë të ndryshëm për realizimin e qëllimeve dhe aktivitetet e përbashkëta, sigurojnë pjesëmarrje në vendimmarrje për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve të rëndësishme shoqërore, ndërtojnë platforma të përhershme për rrjetëzim dhe bashkëpunim.
- 7.3 Organizatat civile në mënyrë objektive dhe të paanshme, ndajnë informacione, resurse dhe njohuri dhe vendimet e rëndësishme shoqërore i sjellin në mënyrë kolektive.
- 7.4 Organizatat civile i mbështesin qytetarët që të marrin role dhe hapa aktivë dhe të përfshihen në procesin e ndryshimeve në nivel lokal dhe kombëtar.



8. KOMUNIKIM I HAPUR I DYANSHËM ME TË GJITHË PALËT

- 8.1 Komunikimi i jashtëm dhe i brendshëm pasqyron vlerat dhe parimet themelore të punës së organizatave të shoqërisë civile. Në aktivitetet dhe marrëdhëniet e tyre me palët e treta, civile i respektojnë parimet e komunikimit të dyanshëm, të qartë, të vërtetë dhe jo të dhunshëm dhe promovojnë kulturë të dialogut të argumentuar.



- 8.2** Organizatat civile ndajnë në mënyrë transparente dhe në kohë informacione në lidhje me misionin, qëllimet, aktivitetet, financat, punonjësit, anëtarët e organeve joekzekutive dhe kontaktet. Informacionet e ndara janë të lehtë për t'u shfrytëzuar për të gjitha palët e interesuara, e në punën e tyre organizatat sigurojnë mbrojtje të të dhënave personale në mënyrë që të mbrohen nga keqpërdorimi. Organizatat civile gjithmonë insistojnë që komunikimi të përshtatet me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- 8.3** Në interesin më të mirë të organizatave civile dhe në interesin e shfrytëzuesve të shërbimeve është përforsimi i frymës së komunikimit të hapur. Qëllimi është promovimi dhe respektimi konsekuent i standardeve të përcaktuara në këtë Kod, si masë bazë e marrëdhënieve tona në kuadër të shoqërisë civile dhe në komunikim me publikun.
- 8.4** Organizatat civile sigurojnë komunikim të dyanshëm dhe inkurajojnë qytetarët dhe të gjithë palët e prekur për t'i shprehur mendimet, sugjerimet dhe komentet e tyre mbi punën e tyre, në mënyrë që të përmirësohen efikasiteti, efektiviteti dhe ndikimi në punë.
- 8.5** Organizatat civile ofrojnë mekanizëm ankesash (të jashtëm dhe të brendshëm), duke krijuar kushte të sigurta dhe procedura të përshtatshme për zgjidhjen e tyre dhe parandalimin e mëtejshëm.

FJALOR NOCIONESH

STATUTI: është akt me të cilin rregullohet veprimtaria, struktura organizative dhe funksionimi i organizatës.

ORGANET EKZEKUTIVE: janë ato organe që janë përgjegjës për operacionet dhe punën e përditshme të organizatës. Në praktikë ato mund t'i hasni të emëruar si: drejtor ekzekutiv ose këshill drejtorësh. Personat që janë pjesë e organeve ekzekutive janë përfaqësuesit juridikë të organizatave civile dhe miratojnë vendime për punën e përditshme të organizatave. Punonjësit në organizatat e shoqërisë civile përgjigjen për punën e tyre para drejtorit ose para këshillit të drejtorëve.

ORGANET JOEKZEKUTIVE: janë ato organe që menaxhojnë organizatat civile dhe që monitorojnë punën e organizatës në lidhje me misionin e caktuar, qëllimet e saj afatshkurtra dhe afatgjata. Në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe organi më i lartë drejtues në organizatat civile është Kuvendi, por shpesh, në praktikë, organizatat civile në përputhje me aktet e tyre themeluese si organe joekzekutive kanë edhe Këshill Drejtues, Këshill dhe/ose Bord Mbikëqyrës.

KUVENDI: si organi më i lartë drejtues në organizatën, e miraton dhe rregullon Statutin e organizatës, ndërsa i miraton programet e punës, strategjinë dhe raportet vjetore. Kuvendi vendos edhe për qëllimet e organizatës dhe strukturën organizative të shoqatës.

KËSHILLI DREJTUES: është organ drejtues i përgjithshëm që mbikëqyr menaxhimin e përditshëm të organizatës. Ky organ miraton politika për funksionimin e organizatës, jep udhëzime të qarta për zbatimin e këtyre politikave dhe monitoron zbatimin e tyre. Shqyrton dhe miraton raportet vjetore të organizatës.

KONFLIKTI I INTERESIT: është situatë në të cilën interesat e jashtme ndikojnë ose perceptohet se ndikojnë në aftësinë e personave përgjegjës për të marrë vendime të drejta dhe të paanshme në emër të organizatës civile.

Përgatitja e këtij Kodi për SHC doli si një nismë e organizatave civile që janë pjesë e rrjetit joformal për transparencën dhe llogaridhënien e organizatave civile që u formua në kuadër të programit “Shoqëria e qëndrueshme civile - Financimi Shtetëror i SHC”. Në kuadër të këtij programi, 29-të rigrantet për përmirësim të transparencës dhe llogaridhënies. Ndërsa përfituesit e granteve si masë kritike e shoqërive civile që punuan për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien e tyre ishin baza për krijimin e rrjetit. Gjithashtu, në kuadër të rrjetit u përfshinë edhe organizata që tanimë e mbulojnë temën dhe punojnë në fushën dhe punojnë në fushën e qeverisjes së mirë dhe vetërregullimit.

Përgatitja e Kodit u realizua në dy faza. Në fazën e parë, përmes mbledhjeve këshillimore me përfituesit e granteve u diskutua gjendja në sektorin civil në aspektin e transparencës dhe llogaridhënies dhe mënyrave si të përmirësohet. Gjithashtu, u realizuan katër punëtori me të cilat organizatat u njohën me mjete të ndryshme për vetërregullim për organizatat civile që janë të pranishme në vendet e rajonit por edhe në nivel global (Sllovenia, Kroacia, Shqipëria dhe Amerika e Jugut). Në përputhje me konkluzionet e këtyre mbledhjeve dhe punëtorive, u theksua nevoja për krijimin e një Kodi për SHC i cili do të afirmonte angazhimin e organizatave civile për të përmirësuar dhe forcuar vazhdimisht transparencën dhe llogaridhënien. Në fazën e dytë, nisi procedura e organizimit të punëtorive të brendshme për përgatitjen e tekstit të Kodit. Në punëtorinë e parë me ndarjen në grupe u diskutuan fushat dhe standardet që duhet të përfshihen në Kod, në përputhje me procesverbalet e grupeve të punës u propozuan tetë fusha dhe një sërë standardesh dhe parimesh të ndara sipas fushave. Sipas asaj që u diskutua, u përgatit dhe u nda draft teksti i parë i Kodit në të cilin u dhanë komente dhe vërejtje. Për përmblidhjen e komenteve dhe vërejtjeve u organizua punëtorja e dytë dhe disa konsultime bilaterale për të përmblidhur komentet dhe vërejtjet në mënyrë që të përmirësohet teksti. Si rezultat i kësaj, u dërgua draft i dytë i cili gjithashtu u nda për komente dhe vërejtje. Draft-teksti i dytë i Kodit u nda me përfituesit e Civika Mobilitas (të cilët janë pjesë e granteve institucionale, aksionale dhe/ose granteve të vogla aksionale) me qëllim përfshirjen më të gjerë të organizatave civile në procesin e përgatitjes. Sipas komenteve në draftin e dytë, u përgatit versioni përfundimtar i Kodit, i plotësuar nga një Udhëzues për zbatimin e Kodit. Kodi dhe Udhëzuesi do të plotësohen vazhdimisht në përputhje me nevojat e sektorit të shoqërisë civile për transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe. Të gjitha organizatat e interesuara, që duan ti qasen Kodit, do të mund ta bëjnë atë duke e plotësuar deklaratën në vijim. Deklaratat dërgohen në Qendrën Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, dhe shqyrtohen në kuadër të takimeve të rregullta në rrjetin e transparencës dhe llogaridhënies. Organizatat civile që do të kenë qasje në Kodin duhet të njoftojnë për zbatimin e Kodit në raportet e tyre vjetore organizative, njoftojnë në mediat e tyre sociale dhe të ngjashme. Hapat e ardhshme për zhvillimin e Kodit janë krijimi i një mekanizmi për të monitoruar zbatimin e Kodit.

DEKLARATË

për pranimin e Kodit

Emri i organizatës	
Adresë	
Kontakti (telefon dhe / ose email)	
Web faqe	
Personi i kontaktit (emri dhe mbiemri dhe e-mail)	

Me këtë DEKLARATË, si përfaqësues i autorizuar i organizatës, unë plotësisht pranoj dhe marr përsipër të zbatoj Kodin e Organizatave të Shoqërisë Civile në punën e organizatës, në mënyrë që të forcojmë sistemin e vetë-rregullimit dhe të kontribuojmë në profesionalizëm dhe llogaridhënie më të madhe tek organizata dhe i gjithë sektori i shoqërisë civile

Emri, mbiemri dhe funksioni i personit të autorizuar

Data

